

Relacion Teknik

Objekti:

Rikonstrukcion i bibliotekes në Pallatin e Kulturës “Ndue Shyti” Puke

Të përgjithshme.

Në qytetin e Pukës ndodhet Pallati i Kulturës “Ndue Shyti”, ku në katin e dytë të saj ka një ambient i biblioteke me shumëllojshmëri librash të zhanreve të ndryshme. Nga statistika ndër vite ka një frekuentim të rregullt për interesimin e librit nga rreth 300 lexues të ndryshëm, të cilët përveç tërheqies së librit për ta studiuar në kushtet e shtëpisë, kërkesa e tyre është edhe për qëndrimin e studimit të librit në auditorin e bibliotekës, por kjo gjë bëhet tej e pakëndshme për shkak të kushteve jo normale, si; lagështia në ambientin e auditorit, rifinitura të dëmtuara, tavolina dhe karrige të amortizuara, mungesa e kompjuterave për lidhjen e leximit me inovacionin e teknologjisë së internetit, etj. Duke marrë shkas nga këto Bashkia Pukë ka prioritet krijimin e kushteve të rritjes së nivelit intelektual, nëpërmjet përmirësimit të ambienteve të bibliotekës në parametrat bashkëkohore, ku i përgjigjet nevojave të lexuesit me zhvillimet e teknologjisë interaktive.

Gjendja aktuale.



Fig. 1 Pamje e standave të librit në bibliotekë.



Në fotot në fig 1 dhe fig. 2 shihet gjëndja e amortizuar e bibliotekës, si dyshemeja, suvatimimet e brendëshme të dëmtuar, dritaret, instalimet elektrike, etj.

Këto dëmtime kanë ardhur nga mungesa e fondeve për të investuar mirëmbajtjen e saj në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike, si dhe nga përdorimi i këtyre ambjenteve në mënyrë intensive nga fluksi i madh i lexuesve dhe miqve të shumtë të librit.

Pallati i kulturës është rikonstruktuar në anën e jashtme të saj, në kuadrin e rivitalizimit urban të qytetit të Pukës nga ana e Bashkisë, kurse ambjentet e brendshme për pamjaftueshmëri të fondeve ka mbetur gjendja ekzistuese. Nisur nga kërkesa në rritje e miqve të librit për frekuentimin e ambjenteve të bibliotekës, si dhe nga gjëndja e pa përshtatshme për shkak të kushteve jo normale të rifiniturave dhe paisjeve që afron kjo qendër, është menduar nga ana e Bashkisë Pukë të hartohet ky projekt-preventiv, me qëllim të sjelljes së kushteve optimale për lexuesit dhe dashamirësit e librit.

Fig. 2 Pamje e dëmtimit të rifiniturave.



Fig. 3 Pamje ekzistuese e sallës së leximit.

Masat inxhinierike.

Duke parë nga afër gjëndjen e amortizuar të rifiniturave të bibliotekës, konkludojmë që dëmtimet e krijuara ndodhen në ambjentet e brëndshme të saj, kryesisht në rifinitura, për të cilën është hartuar

edhe ky projekt-preventiv.



Fig. 4 Pamja 3D e sakkës së leximit të rikonstruktuar.

Në projekt është parashikuar :




Fig. 5 Planimetria e ambienteve për zbatimin e punimeve.

Punimet që janë parashikuar të zbatohen sipas këtij projekti përfshijnë ambientet :

- Holli
- Magazina e librarisë
- Salla digjitale
- Zyra e Asistentit

1. Punime prishje.

1. Punime prishje			
1	Prishje suvatime ne mure	m2	135
2	Prishje suvatimi ne tavan	m2	178

3	Prishje shtrese derrasa FM 2.5cm	m2	88,4
4	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 7.0 km	m3	11,878

2. Punime Ndërtimi.

1	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah	m2	178
2	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	135
3	Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva.	m2	126,1
4	Patinim tavani allçi (stuko)	m2	232
5	Boje hidroplastike	m2	727
6	Shtrese parketi	m2	88,4
7	Shtrese me pllaka grez importi 40 x 40 cm	m2	130,6
8	Plintuse grez importi, h = 10 cm	ml	165
9	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	24,20
10	Pragje dritare me pllake mermeri	m2	9,5

3. Punime elektrike. Instalimet ekzistuese do të prishen dhe nuk janë pjesë e këtij projekti, pasi të gjitha instalimet elektrike janë parashikuar të reja, vetëm për ambientet e lartpërmendura.

4. Punime interneti. Janë parashikuar 13 dalje, porta për kompjutera (në mure).

PUNOI:
ING. LAVDRIM BRUKA